



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKQYRËS

Nr. 12/4 Prot

Tiranë, më 24 / 12 / 2019

PLAN VEPRIMI 2020

I nderuar Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të ATK-së,

Në zbatim të Ligjit Nr.8894, Datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.33, datë 24.09.2010 të Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Agjencisë së Trajtimit të Kredive si dhe në vijim të procesit të raportimit, ju paraqes plan veprimin e vitit 2020.

HYRJE

Misioni i Agjencisë së Trajtimit të Kredive është mbledhja e kredive të këqija të ish bankave të nivelit të dytë me kapital shtetëror dhënë prej tyre deri në vitin 1998 në favor të buxhetit të shtetit.

Realizimi me sukses i këtij misioni do të:

- Japë zgjidhje me sukses për kërkesat ndaj debitorëve,
- Trajtojë debitorët e INSING,
- Arkëtojnë në favor të shtetit fondet e parashikuara në proces të saj me kosto sa më të ulët.

Në kuadër të këtij misioni gjatë vitit 2020 do të vazhdojnë masat administrative për të përmirësuar punën dhe për të zgjidhur problematikat e krijuara.

Nga të dhënat e nxjerra rezulton se nga ana e stafit në vitin 2019 janë përpunuar një numër i konsiderueshëm prej 8,000 shkresash hyrëse dhe dalëse. Gjithashtu janë pritur dhe sqaruar pranë zyrave tona më shumë se 600 debitorë, të cilët kanë kërkuar takime, duke iu vendosur në dispozicion informacionin përkatës. Janë ndjekur 40 procese gjyqësore duke e cuar në 176 numrin e seancave të zhvilluara me palë ATK-në, prej të cilave 14 janë fituar me vendim të formës së prerë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKQYRËS**

Kemi patur bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjëndjes Civile ku më shumë se 1000 adresa të debitorëve janë saktësuar sipas rregjistrat aktual. Në funksion të evidentimit të debitorëve është kërkuar dhe po vijon bashkëpunimi me 61 njësitë e qeverisjes vendore pasi janë marrë kontaktet e nevojshme me administratorët e këtyre njësive dhe janë afishuar në vende të dukshme listat e tyre. Këtë vit kemi ri-filluar marrëdhënien e bashkëpunimit me Zyrën e Përmbartimit Shtetëror duke shpresuar se do kemi rezultate në punën tonë për evidentimin e debitorëve në zonat përkatëse.

Eshtë bërë një punë intensive për të zgjidhur problematikat ligjore të mbartura prej vitesh në plotësimin e dokumentacionit, nxjerrjen e dublikatit të Urdhër Ekzekutimit si dhe plotësimin e dokumentacionit të pronësisë për pronat që janë kaluar nga përmbartuesit gjyqësorë në pronësi të ATK-së.

Do të vazhdohet puna për saktësimet e adresave për gjetjen e debitorëve me principal të ulët, të cilët për marrjen e kredisë nuk kanë lënë kolateral si garanci dhe gjetja e vendbanimit aktual të tyre rezulton më e vështirë.

Nëse do të referohemi proceseve gjyqësore, debitorët me principal të lartë të transferuar janë më të prirur për të ngritur padi për pavlefshmëri titulli në krahasim me debitorët me principal të ulët.

GJENDJA E DEBITOREVE

Debitorët janë grupuar sipas portofoleve të ndarë me zona dhe me detyrimin sipas principalit të transferuar si më poshtë:

Tiranë – Durrës – Kavajë – Krujë

Nga 0-100,000 lekë	762 debitorë
Nga 100,000-500,000 lekë	398 debitorë
Nga 500,000-1,000,000 lekë	269 debitorë
Mbi 1,000,000 lekë	194 debitorë



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIQYRËS

Në total janë **1,623** debitorë, nga të cilët 813 kanë lënë kolateral pasuri të patundshme si garanci në favor të bankës.

Shkodër - Malësi e Madhe – Lezhë - Pukë - Laç- Mirditë

Nga 0-100,000 lekë	2094 debitorë
Nga 100,000-500,000 lekë	826 debitorë
Nga 500,000-1,000,000 lekë	146 debitorë
Mbi 1,000,000 lekë	100 debitorë

Në total janë **3,166** debitorë, nga të cilët 1,322 kanë lënë kolateral pasuri të patundshme si garanci në favor të bankës.

Mat-Bulqizë-Dibër-Kukës-Has-Tropojë

Nga 0-100,000 lekë	1,249 debitorë
Nga 100,000-500,000 lekë	1,168 debitorë.
Nga 500,000-1,000,000 lekë	383 debitorë
Mbi 1,000,000 lekë	128 debitorë

Në total janë **2,928** debitorë, nga të cilët 1,415 kanë lënë kolateral pasuri të patundshme si garanci në favor të bankës.

Elbasan – Gramsh – Peqin – Librazhd – Korçë – Devoll - Pogradec

Nga 0-100,000 lekë	554 debitorë
Nga 100,000-500,000 lekë	610 debitorë
Nga 500,000-1,000,000 lekë	170 debitorë
Mbi 1,000,000 lekë	173 debitorë



MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKQYRËS

Në total janë **1,507** debitorë, nga të cilët 1,094 kanë lënë kolateral pasuri të patundshme si garanci në favor të bankes.

Mallakastër – Fier – Berat – Skrapar – Kuçovë - Lushnjë

Nga 0-100,000 lekë	514 debitorë
Nga 100,000-500,000 lekë	286 debitorë
Nga 500,000-1,000,000 lekë	177 debitorë
Mbi 1,000,000 lekë	267 debitorë

Në total janë **1,244** debitorë, nga të cilët 977 kanë lënë kolateral pasuri të patundshme si garanci në favor të bankës.

Tepelenë – Përmet – Gjirokastër – Sarandë - Vlorë

Nga 0-100,000 lekë	326 debitorë
Nga 100,000-500,000 lekë	247 debitorë
Nga 500,000-1,000,000 lekë	116 debitorë
Mbi 1,000,000 lekë	115 debitorë

Në total janë **804** debitorë, nga të cilët 586 kanë lënë kolateral pasuri të patundshme si garanci në favor të bankës.

Nga sa më sipër numri total i debitorëve është **11,272** debitorë. Pasuri të patundshme të lëna si garanci për kreditë e dhëna janë **6,207** prona.



REPUBLIKA E SHqipëRIE

**MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVË
KËSHILLI MBIQYRËS**

PROBLEMATIKAT LIGJORE TË HASURA NË MBLEDHJEN E DEBISË

Në gjykimin tonë në vitet e ekzistencës së saj qëllimi kryesor i Agjencisë ka qënë mbledhja e debisë duke u fokusuar vetëm në realizimin e targetit të përcaktuar. Kjo ka bërë që vëmendja ndaj evidentimit të problematikave ligjore të jetë e ulët. Aktualisht institucioni nuk ka të dhëna të sakta lidhur me mundësinë reale dhe gjendjen ekonomiko-sociale të debitorëve për kthimin e debisë. Gjatë punës janë krijuar probleme ligjore të ndryshme si shitja e pronës në ankand pa bërë më parë vecimin e pjesës takuese, shitja e pronës pa dokumentacionin përkatës apo duke mos ndjekur vijimin e procedurave që janë vënë në ekzekutim sidomos në Përmbarrimin Shtetëror. Ndryshimet e vazhdueshme të stafit si dhe puna pa një strategji të mirëfilltë të mbledhjes së debisë ka ndikuar negativisht në krijimin e një database të abdetuar, të cilit mund ti referohesh dhe të gjenerosh raporte të detajuara.

Në mënyrë të përmbledhur po paraqesim problemet ligjore, të cilat ndikojnë në realizimin e planit dhe mbledhjen e debisë.

Problematikë paraqitet situata në gjetjen e adresave të sakta të debitorëve. Sektori juridik dhe operacional ka ngritur grupe pune, të cilat po verifikojnë dhe po evidentojnë debitorët në terren. Ky proces ka vështirësi pasi lëvizjet demografike të popullsisë të këtyre viteve kanë qënë të shumta. Nëse do të analizojmë arsyet e marrjes së kredisë ato janë marrë kryesisht në zonat rurale në mbështetje të ekonomisë familjare të fshatrave.

Jemi duke vijuar bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Nga përfaqësuesit e tyre është duke u shkëmbyer informacion i vazhdueshëm me numra kontakti si dhe me saktësimet e adresave të debitorëve. Gjithashtu këto njësi po realizojnë afishimin e listave të debitorëve pranë zyrave të njësive në mënyrë që të evidentohen rastet e zonës.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIQYRËS**

Rezulton se shumë nga debitorët janë larguar jashtë vendit ose nuk gjendet vendbanimi i saktë i tyre. Në këto raste zyrat përmbarimore nuk kanë vazhduar me procedurat për caktimin e përfaqësuesit ligjor pasi bazuar në nenin 522 të Kodit të Procedurës Civile shpenzimet për këto raste duhet të parapaguhen nga pala kreditore, e cila është (40,000+8,000 tvsh) për cdo rast që duhet caktuar përfaqësuesi ligjor për vazhdimin e ekzekutimit.

Ky fakt bën që veprimet përmbarimore të pezullohen, pasi shpenzimet që parapaguhen për këtë shërbim janë shumë të larta dhe numri i debitorëve që nuk gjenden është i konsiderueshëm.

2. Nëse analizojmë vlerën e kolateralit të lënë në favor të bankave, në momentin e dhënies së kredisë nuk është kryer një vlerësim i saktë i kolateralit. Përvec kësaj vlere e pronave gjatë këtyre viteve ka qënë në rënie, gati i papërfillshëm në raport me vlerën e borxhit. Kostot e procedurës për nxjerrjen në ankand të këtij kolateralit janë shumë të larta në raport me vlerën reale që ai ka në treg apo në lidhje me përfitimin ekonomik që do të realizonte agjencia në raport me shpenzimet. Kolaterali kryesisht është në zona rurale, vlere e të cilit në treg është shumë e ulët. Nga vlerësimi që ju kemi bërë rasteve rezulton se kjo garanci nuk është vendosur në formën e kërkuar nga ligji dhe është lënë garanci prona në bashkëpronësi pa miratimin e të gjithë bashkëpronarëve. Kjo e bën të pamundur marrjen e kolateralit pa bërë si fillim vecimin e pjesës takuese në gjykatë dhe më pas nxjerrjen në ankand të kësaj pjese. Sic mund të konstatohet edhe keto veprime juridike kanë një kosto të lartë, pasi padia në gjykatë për vecimin e pjesës takuese kërkon parapagimin e ekspertit vlerësues të pasurisë. Gjithashtu procedura e ankandit për shitjen e këtyre pronave është e vështirë dhe nuk sjell përfitime në funksion të mbledhjes së debisë.

Vlora e një ankandi është (1 pagë minimale 26,000 +tvsh) si dhe shpenzimet për ekspert vlerësues dhe publikime.

Nëse nuk bëhet më parë veprimi mbi kolateralin e lënë garanci nuk mund të vazhdohet procedura e ekzekutimit nga përmbaruesit gjyqësorë mbi pasuri të tjera. Ndërkohë nga vlerësimi parapak që specialistët ju bëjnë rasteve rezulton se shpenzimet për këtë proces janë të larta dhe vlere e kolateralit nuk e mbulon shpenzimin e kryer. Po punohet për evidentimin e të gjitha këtyre rasteve.

Në rastet që kemi vijuar me procedurën është konstatuar se pronat kanë problem me dokumentacionin tekniko ligjor. Kanë mangësi dokumentacioni si në origjinën e pronësisë ashtu edhe në hedhjen e të dhënave të sakta të gjendjes juridike. Mungesa e fondeve për të



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKQYRËS

ruajtur dhe mirëmbajtur këto prona ka bërë që përsëri ti lihen në ruajtje debitorit. Kjo gjë ndikon negativisht në mbledhjen e borxhit.

Agjencia e Trajtimit të Kredive aktualisht ka në pronësi të saj 73 prona, të cilat janë marrë në pronësi me një vlerë prej **170 milion lek.**

E njëjta situatë është edhe për sendet e luajtshme, mjetet motorike, të cilat mbasi janë sekuestruar dhe kaluar në pronësi në ATK-së i janë lënë përsëri në ruajtje debitorit dhe nuk është bërë zbritja e detyrimit. Mjetet sot janë të amortizuara totalisht. Por edhe në rast se do të vendosnim bllokim fizik të mjeteve e kemi të pamundur përballimin e kostove për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre. Gjithashtu në lidhje me vendosjen e barrës siguruese mbi mjetet, me ndryshimet ligjore të sistemit të regjistrimit të mjeteve nuk është DPSHTR organi kompetent për vendosjen e barrës siguruese por institucioni i Regjistrimit të Barrës Siguruese. Si rrjedhojë, do të bëhet lirimi i të gjitha urdhrave të bllokimit mbi mjetet e debitorëve. Gjithashtu tarifa për kryerjen e shërbimit nga RBS kushton 1,400 lekë. Për këtë arsye lind nevoja e nënshkrimit të një Marrëveshje ndërmjet ATK dhe RBS (Regjistri i Barrës Siguruese), për përjashtimin nga pagesa e tarifave.

3. Mosha e debitorëve është një faktor, i cili ndikon në ecurinë e procesit të mbledhjes së borxhit. Me kalimin e viteve shumë nga kredimarresit kanë dalë në pension dhe është ligjërisht e pamundur vjelja e detyrimit nga pensioni, pasi nuk mund të cënohet minimumi jetik i qytetarëve dhe në shumicën e rasteve të evidentuara nuk disponojnë pasuri apo mjete të tjera jetese.

4. Cilësia profesionale e punës në hartimin e dokumentave nga ana e punonjësve të ish bankave ka qënë e ulët. Në dokumentacionin e kredisë mungojnë të dhënat dhe gjeneralitetet e debitorëve, të dhënat për datëlindjen, atësinë. Nga verifikime të ndryshme që kemi realizuar kanë rezultuar se dalin disa persona, me të dhënat që disponojmë duke e bërë praktikisht të pamundur identifikimin e debitorit. Edhe këto raste duhen evidentuar pasi ligjërisht mbledhja e kësaj debie është e pamundur.

5. Duke qënë se këto kredi janë dhënë përpara vitit 1997 dokumentacioni në banka të disa qyteteve të Shqipërisë u dogj dhe shkatërrua. E vetmja e dhënë për këto debi është procesverbali i transferimit. Në bazë të nenit 10 të Ligjit, Nr.8894, Datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Kredive" I ndryshuar "Për huatë e transferuara në Agjencinë e Trajtimit të Kredive pa dokumentacionin ligjor që vërteton marrjen e kredisë, procesverbali i transferimit të detyrimit kontabël të këtyre huave përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga përmbaruesi



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKQYRËS

gjqësor”. Për urdhrat e ekzekutimit që kanë dalë bazuar në procesverbal është shpallur i pavlefshëm ekzekutimi nga gjykata pikërisht sepse nuk mund të provohet ekzistenca e debisë me prova shkresore nga ana e Agjencisë në lidhje me kredimarrësin sepse Kontrata individuale e Huasë nuk gjendet. Edhe keto raste nga ana ligjore mund të konsiderohen kredi të humbura dhe identifikimi i tyre do të shërbente për t’ju afruar sa më shumë vlerës reale të debisë që mund të jetë akoma e mundur për tu ekzekutuar.

6. Nga verifikimet që po realizohen dhe nga përgjigjet e marra nga përmbaruesit pas vënies në ekzekutim të dosjeve është evidentuar se shumë nga debitorët kanë vdekur. Celja e dëshmisë së trashëgimisë është gjithashtu një proces që kërkon kosto të larta dhe jemi duke bërë një vlerësim rast pas rasti në funksion të përfitimit ekonomik që ka Agjencia, duke realizuar arkëtimet pa krijuar kosto. Edhe ky proces paraqitet me problem, pasi nga verifikimet rezulton se debitorët nuk kanë patur pasuri e për rrjedhojë trashëgimtarët nuk kanë detyrime për këto debi. Për rastet të cilat nga verifikimi ka rezultuar që debitorët kanë patur pasuri ka vijuar procedura për vjeljen e detyrimit.

7. Kemi evidentuar 75 sh.p.k me vlerë totale principali **293 milion leke**. Problemi me këto shoqëri është pasi nuk janë të hedhura në regjistrin aktual të QKB-së, janë pa NUIS të vlefshëm, rrjedhimisht statusi i tyre nuk është aktiv. Në mënyrë që të vijojmë me procedurën e mbledhjes së debisë bazuar në nenin 6 të Ligjit, Nr.8894, Datë 14.05.2002 “ Për Agjencinë e Kredive” i ndryshuar duhet ti drejtohem gjykatës për shpalljen e falimentit dhe caktimin e një likuidatori. Edhe ky proces ka kosto të madhe dhe nga të dhënat e mbledhura këto shoqëri nuk kanë pasuri.

8. Problematikë mbetet rritja e numrit të proceseve gjyqësore. Proceset gjyqësore janë me padi të ngritura për pavlefshmëri titulli ose për pretendim të plotësimit të afatit të parashkrimit.

9. Vlen për tu përmendur dhe problematika në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Ne si institucion kemi marrë të gjitha masat në mënyrë që të vijonte bashkëpunimi me ASHK por kjo Marrëveshje nuk u finalizua, duke krijuar një pengesë në ecurinë e punës për gjetjen e kolateraleve të debitorëve.

Në total dosjet që janë në ekzekutim të detyrueshëm pranë Shërbimit përmbarimor privat janë 1892 dosje dhe pranë atij Shtetëror 50 dosje. Vlera totale e principalit të kësaj debie është për përmbarimin privat 2,177,178,887 lekë dhe për përmbarimin shtetëror 23,446,433



MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKQYRËS

lekë. Duke pasur një principal të konsiderueshëm në ekzekutim pritshmëritë që kemi nga dosjet janë të larta në realizimin e targetit.

Jemi duke evidentuar të gjitha rastet, të cilat nga ana e përmbaruesve është vendosur sekuestro konservative mbi pasuritë në bashkëpronësi dhe po bejmë një vlerësim të plotë të përfitimit që do të realizojmë nëse nga ana e bashkëpronarit jepet pëlqimi për blerjen e pjesës takuese sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile.

Mendojmë se identifikimi i këtyre rasteve si dhe marrja e detyrimit për aq sa mundësi reale ka debitori do të japë një të dhënë të saktë për fuqinë paguese duke e konsideruar të humbur pjesën tjetër, të paktën si pritshmëri reale të kthimit të borxhit.

Gjithashtu po punojmë për plotësimin e dokumentacionit ligjor për disa prona, të cilat kanë kaluar me vendim nga përmbaruesit në pronësi të ATK-së, duke bërë aplikimet në ASHK përkatëse për tu pajisur me çertifikatë pronësie. Gjithashtu kanë filluar procedurat për nxjerrjen në ankand të pronave me qëllim rritjen e arkëtiveve. Vlera e tyre e rivlerësuar sipas ekspertit të licensuar shkon në **141 mln lekë**.

Intensifikimi i marrëdhënieve ndër-insitucionale pritet të japë efekte pozitive në realizimin e objektivit kryesor që ka Agjencia, mbledhjen e borxhit dhe arritjen e targetit vjetor. Për këtë qëllim do të vazhdohet me rifreskimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me ASHK, lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi me RBS si dhe me institucione të tjera.


Në funksion të realizimit të tyre do të krijojmë mundësitë për marrëveshje bashkëpunimi me OSSHE dhe Postën Shqiptare për saktësimin e adresave dhe evidentimin e tyre në terren.

Një marrëveshje e rëndësishme do të ishte edhe ajo me AKEP për numrat e kontaktit të debitorëve si dhe me Bankën e Shqipërisë.

Spektori i Menaxhimit të Riskut

Vlen për tu përmendur se gjatë vitit 2019, si pjesë e strukturës së ATK u krijua Spektori i Menaxhimit të Riskut, për të vlerësuar mundësinë e vjeljes së detyrimit për secilin prej debitorëve, duke u bazuar në evidentimin fizik dhe analizën ligjore të dosjeve nga Spektori Juridik dhe Operacional. Janë përfunduar rrethet Përmet, Gjirokastër, Sarandë, Vlorë ku janë përcaktuar dokumentacioni ligjor dhe kolaterali i lenë si garanci.

Ky sektor ka nisur punën e tij me hartimin e formulës së riskut, ku fillimisht janë analizuar kartelat individuale për debitorët në monedhë të huaj, meqënëse numri i tyre ishte më i vogël në krahasim me atyre në lek.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKQYRËS

Do të vijojë puna me evidentimin e dosjeve të gjitha zonave nga sektori juridik, zbatimi i formulës së riskut nga Sektori i Menaxhimit të Riskut, duke i klasifikuar dosjet në bazë të rrezikut potencial si dhe duke dhënë një vlerësim në lidhje me mundësinë e vjeljes së detyrimit.

Sektori i Menaxhimit të Riskut po merr gjithashtu në analizë dhe kolaterale të pronësi të ATK-së për të parë mundësinë e ankandit të pronave që janë me përfitueshmëri nga ana jonë.

Puna e Sektorit të Menaxhimit të Riskut do të fokusohet në plane afatshkurtra për realizimin e planeve mujore të arkëtimeve, por jo vetëm do të shikojë dhe mundësinë e planeve afatgjata duke krijuar regjistrin pasiv, i cili do të përfshijë debitorë ndaj të cilëve ATK ka ndjekur cdo proces dhe i ka etiketuar të tillë për faktin që nuk mundet të ketë likuidim detyrimi.

Konkluzione : Sipas vlerësimit tonë fokusi i punës së Agjencisë së Trajtimit të Kredive duhet të jetë identifikimi i debitorit dhe kontaktimi i tij. Në këtë mënyrë do të krijohet një e dhënë e saktë mbi gjendjen ekonomiko-sociale të tij duke nxjerrë edhe pritshmëritë e kthimit të detyrimit. Vlerësimi i punës së stafit nuk mund të jetë më vetëm nëpërmjet arkëtimeve, por edhe puna për analizën reale të borxhit të mbetur.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

